



K.DH.SH.II.nr.610/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit E...., me seli në Pejë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokat Granit Vokshi kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit L.B, me bazë juridike, obligim i taksës së akcizës, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.3140/19 të datës 13.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.11.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit E..., me seli në Pejë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.3140/19 të datës 13.04.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.3140/19 të datës 13.04.2021, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit E..., me seli në Pejë, ndërsa mbetet në fuqi aktvendimi nr.07.3/1188/2015, i datës 14.11.2019, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi E..., me seli në Pejë, (*pretendime të kuptuara nga arsyetimi i ankesës*) . Me propozim që të aprovohet në tërësi si fatikisht dhe juridikisht ankesa e paditësit, të anulohet aktvendimi A.nr. 3140/19 i datës 13.04.2021 ashtu që të anulohet vendimi nr. 07.3/1188/2015 i datës 14.11.2019 i Doganës së Kosovës.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr. 07.3/1188/2015 i datës 14.11.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar ankesa e subjektit “...” Shpk me seli në Pejë, për rishqyrtimin e aktvendimit me nr. i datës 03.11.2015 i lëshuar nga Sektori i Akcizave, si i pa bazuar.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të Doganës së Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 30.12.2019, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr. 07.3/1188/2015 i datës 14.11.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar, duke lënë në fuqi aktvendimin e lartcekur të Doganës së Kosovës në Prishtinë. Me arsyetim se aktvendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Prandaj, në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata ka konstatuar se aktvendimi i lartcekur është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Ndërsa për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, Dhoma e Shkallës së Dytë gjeti se gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit nuk ka bërë shkelje të dispozitave LKA-së dhe LPK-së.

Sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë në konsideratë paragrafin 3.6 të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndonëse vendimi është i qartë ku i referohet secilit pozicion, pra secilës ulëse në ruleta. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka konstatuar gjendjen faktike duke gjetur si të mjaftueshëm arsyetimin e të paditurës lidhur me refuzimin për pasivizim të 24 ulëseve (pozicioneve), ndonëse të njëjtin nuk e citon se cilën pjesë të këtij arsyetimi e konsideron sit ë mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm, pasi që e paditura askund nuk ka cekur se cilës bazë ligjore i referohet, po ashtu e paditura nuk ka kapacitete administrative për kontrollimin e pasivizimit të ulëseve dhe ndaj paditësit është bërë padrejtësi kur është obliguar që të paguaj normën e tatimi të akcizës. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase të njëjtat janë të pa qëndrueshme dhe të pa argumentuara me prova konkrete, për vërtetimin e

gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Sepse nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ dhe në bazë të legjislacionit doganor, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se në procedurën administrative gjendja faktike është vërtetuar de jure kur është nxjerrë konkluzioni se kërkesa e subjektit në procedurë është e pa bazuar pasi që Ruletet si makinë elektronike me ulëset përcjellëse është licensuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), dhe në vendimin e Qeverisë së Kosovës është vendosur norma e tatimit të akcizës për lojrat e fatit, ku në paragrafin 3.6 është e përcaktuar shuma e tatimit të akcizës për një Ruletet si makinë elektronike. Prandaj, nga kjo dispozitë ligjore gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka pranuar konstatimet e të paditurës se kërkesa e paditësit për pasivizimin e 24 ulëseve nga Ruletet, nuk gjen mbështetje ligjore, pasi që Dogana e Kosovës konform autorizimeve ligjore me datën 03.08.2015 ka hapur depon e subjektit dhe ka pasivizuar 25 aparate të lojrave të fatit, ndërsa kërkesa e subjektit për pasivizimin e 24 ulëseve të ruletave nuk ka bazë ligjore për tu aprovuar pasi që në ratin konkret bëhet fjalë për më shumë se gjysmën e ulëseve me të cilat është licensuar Ruletet, pra çështja nuk është e regulluar sipas legjislacionit në fuqi dhe as nga praktika nuk ka pasur raste kur një Ruletet është importuar me 8 ulëse por me kërkesë të ndonjë kompanie janë licensuar më pak ulëse. Andaj e paditura në arsyetimin e vendimit kontestues jep sqarime të mjaftueshme lidhur me refuzimin e kërkesës së paditësit për pasivizimin e 24 ulëseve të Ruletave.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin kur ka lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË
K.DH.SH.II.nr.610/22, me datë 10.11.2022

Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti

